

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti Për Krimeve Të Rënda, me gjyqtarin Arben Hoti, në cilësinë e kryetarit të trupit gjykues, dhe sekretaren juridike Shqipe Rexhepi, në lëndën penale kundër të pandehurit K. B., për shkak të veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374/1 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë PP/I.nr.584/14 të dt.27.10.2015, pas shqyrtimit fillestar me datë 15.05.2017, në të cilën ishin të pranishëm Prokurori i Shtetit Armend Hamiti, i pandehuri K. B. si dhe mbrojtësi av. B. E. sipas autorizimit, mori dhe publikisht shpalli këtë:

AKTGJYKIM

I pandehuri: K. B., me nofkën “K.”, i biri i A. dhe S., e gjinisë H., i lindur me dt.*data e lindjes...*, në L.-M., me vendbanim në P., rr”...” nr...., kamerier, i pamartuar, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, kundër tij është duke u zbatuar hetimi për shkak të dyshimit të arsyeshëm se ka kryer veprën penale Vrasje e rëndë nga neni 179 i KPRK-së.

ËSHTË FAJTOR

Sepse: I pandehuri K. B. e ka mbajtur në pronësi armën duke shkelur ligjin e zbatueshëm për armë, në atë mënyrë që prej ditës së pacaktuar të shtatorit 2013 deri më 24. 01.2014 në shtëpinë e tij në P., rr”...” nr. ...ka mbajtur në pronësi pistoletën me gas të tipit “Reck model PP” të kal. 9 mm me nr. serik M-171064 duke shkelur nenin 3 të Udhëzimit administrativ nr. 01/10-MPB për legalizimin e armëve të zjarrit që i takojnë kategorisë B, C dhe D1 sipas të cilit personat fizik nuk mund të posedojnë armë zjarri pa pasur leje të lëshuar nga Departamenti i Sigurisë Publike të MPB- së.

- Me këtë ka kryer veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374/1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata bazuar në nenin e lartpërmendur dhe nenet **7,17,21,41,43,46,73** të KPRK-së si dhe nenit 365 të KPPK –së, e gjykon:

DËNIM ME GJOBË

Të pandehurit K. B.t , i caktohet dënim me gjobë prej 800 (tetëqind) euro, të cilin dënim është i bliguar t’a paguaj në afat prej 30 ditëve, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse i pandehuri nuk e paguan dënimin e shqiptuar, do t’i zëvendësohet me dënim me burgim, ashtu që për çdo 20 euro të gjobës së pa paguar do t’i llogaritet një ditë burgimi.

Obligohet i pandehuri që të paguajë shpenzimet e procedure penale dhe atë paushallin gjyqësor në shumën prej 50 euro, në afatin prej 30 ditëve, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Komfor nenit 69 të KPRK-së dhe nenit 115 të KPPK-së konfiskohet: pistoleta “Reck model-PP” të kal. 9 mm me gas me nr. serik M-171064”, prodhim gjerman.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë ka ngritur aktakuzë PP/I.nr.584/14, të datë 27.10.2015, me të cilën e ka akuzuar të pandehurin K. B., për shkak të veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374/1 të KPRK-së.

Me datë 15.05.2017, Gjykata Themelore në Prishtinë ka caktuar dhe mbajtur seancën fillestare në këtë çështje penale, në të cilën Prokurori i Shtetit ka lexuar akuzën PP/I.nr.584/14, të datë 27.10.2015, ndërsa Kryetari i Trupit Gjykues pasi që u bind se i pandehuri e ka kuptuar akuzën, të njëjtit i dha mundësinë konform nenit 246 par.4 të pranojë fajësinë ose të deklarohej i pafajshëm.

I pandehuri K. B., në shqyrtimin fillestar e ka pranuar fajësinë për veprën penale e cila i është vënë në barrë, duke shtuar se e pranon fajësinë për veprën penale që i vihet në barrë dhe i vjen keq për veprën e kryer dhe njëherit i premtoj gjykatës se më nuk do të përsëris veprën penale.

Mbrojtësi av.B. E. ka deklaruar se është konsultuar mjaftueshëm me klientin e tij, dhe siç shihet edhe nga arsyetimi i akuzës, K. B. ka pranuar fajësinë lidhur me veprën penale për të cilën është dyshuar duke i ditur benefitet e pranimit të fajësisë në shqyrtimin fillestar me vullnet të plotë pranon fajësinë me qëllim që Gjykata në momentin e matjes së dënimit të merr si rrethanë lehtësuese pranimin e fajësisë, pendimin e tij të sinqertë, i cili është një garanci e fortë se në të ardhmen nuk do të kryej më vepra penale, duke e lutur Gjykatën që si rrethanë lehtësuese të ketë parasysh faktin se është i moshës së re dhe se në të kaluarën nuk ka rënë ndesh me ligjin, andaj edhe shqiptimi i dënimit me gjobë do të arrihte qëllimin e dënimit të paraparë me nenin 41 të KPRK-së..

Prokurori i shtetit Armend Hamiti pas deklarimit të të pandehurit, deklarojë se duke pasur parasysh se i akuzuari përveq shpjegimeve nga ana e Gjyqtarit, pashtu e ka pasur edhe avokatin mbrojtës sipas autorizimit, i cili ka pasur kohë të mjaftueshme që të kosullohet me të njëjtin dhe të njoftohet me përparësit se çka ndodh me pranimin e fajësisë, i njëjti në mënyrë vullnetare dhe në përputhje me ligjin e pranoj fajësinë e cila pashtu është në përputhje me provat që janë paraqitur në aktakuzë, andaj si e tillë është e pranueshme.

Megenëse i pandehuri e ka pranuar fajësinë gjykata konstatoi se janë plotësuar kriteret nga neni 248 par. 1 të KPPK-së, I pandehuri ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, pranimi është bërë vullnetarisht, pranimi mbështetet në provat dhe faktet që përmban akuza, siç janë: Procesverbali mbi intervistimin nga hetuesi policor me 24.01.2014 si dhe foto dokumentacioni që gjendet në shkresat tjera të lëndës.

Me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat e parapara sipas nenit 73 të KPRK-së që ndikojnë në matjen e dënimit, ku si rrethana veçanërisht lehtësuese për të pandehurin mori pranimin e fajësisë nga i pandehuri, pendimin e thellë të shprehur nga ana e të pandehurit, si dhe moshën e tij të re, ndërsa rrethana veçanërisht rënduese gjykata nuk gjeti. Gjykata të pandehurit i shqiptoi dënim me gjobë si në pjesën dënuese të këtij aktgjykimi, duke marrë parasysh shkallën e përgjegjësisë penale të pandehurit, rrethanat në të cilat është kryer vepra penale, duke qenë e bindur se me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi ndëshkimor, në kuptim të preventivës individuale, që të parandaloj të pandehurin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, si dhe të arrihet qëllimi ndëshkimor në kuptim të preventivës gjeneralë që të parandaloj personat e tjerë nga kryerja e veprave penale.

Vendimi mbi konfiskimin e sendeve u mor komfor nenit 115 të KPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale u mor komfor nenit 450 të KPRK-së.

Nga sa u tha më lart u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
PKR. nr.616 /15, datë 15.05.2017

Sekretarja Juridike:
Shqipe Rexhepi

Gjyqtari:
Arben Hoti

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, prej momentit të marrjes së këtij aktvendimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate.